

RoadMap for improving the quality and responsiveness of VET – Theory and Practice

Newsletter 1

Issue No: 1 | Shkurt 2026



Projekt Nr: 101183369



Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti financiar nuk mund të mbahen përgjegjës për to.

Rreth Projektit

Financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të Programit Erasmus+ – Capacity Building në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional (VET), RAPPORT – RoadMap for Improving the Quality and Responsiveness of VET – Theory and Practice (Marrëveshja e Grantit Nr. 101183369) synon të përmirësojë cilësinë dhe aftësinë e reagimit të sistemeve të VET ndaj zhvillimeve socio-ekonomike dhe nevojave të tregut të punës.

RAPPORT zbatohet në kuadër të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën dhe bashkon një partneritet shumëpalësh të organizatave aktive në fushën e VET nga Qipro, Greqia, Italia, Shqipëria dhe Bosnja & Hercegovina.

Projekti mbështet ofruesit e VET, Dhomat e Tregtisë, trajnerët dhe aktorët e tjerë të interesit në:

- Forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë
- Modernizimin e kurrikulave
- Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve
- Integrimin e aftësive të gjelbra, digjitale dhe sipërmarrëse
- Promovimin e validimit të të nxënimit joformal
- Përmirësimi i shërbimeve të orientimit në karrierë
- Sigurimi i një VET gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm

Përmes një qasjeje “teori – pastaj praktikë”, RAPPORT kombinon ngritjen e kapaciteteve me zhvillimin dhe zbatimin praktik të kurrikulave, duke siguruar që njohuritë e përfituara të përkthehen në rezultate konkrete dhe të qëndrueshme në sistemet e Arsimit dhe Formimit Profesional.

Objektivat:

1. Rritja e kapaciteteve të partnerëve në sigurimin e cilësisë, hartimin e kurrikulave, angazhimin e aktorëve të interesit dhe praktikën gjithëpërfshirëse në VET.
2. Zhvillimi i kurrikulave të përshtatshme dhe reaguese që përmbushin standardet e kualifikimit, pasqyrojnë nevojat e tregut të punës dhe integrojnë mësimin e bazuar në punë si dhe validimin përmes mikrokredencialeve.
3. Forcimi i ekspertizës në e-learning për krijimin e materialeve trajnuese asinkrone me cilësi të lartë.
4. Promovimi i mësimin të bazuar në punë, duke mbështetur ofruesit e VET në hartimin dhe ofrimin e programeve praktike, të përshtatura me kërkesat e tregut të punës.
5. Krijimi i një platforme online për shpërndarjen e burimeve, materialeve trajnuese dhe praktikave të mira.
6. Forcimi i validimit të të nxënimit joformal përmes mikrokredencialeve dhe instrumenteve ISO 17024.
7. Përmirësimi i orientimit në karrierë për të harmonizuar më mirë aftësitë e nxënësve me mundësitë e punësimit.
8. Nxitja e kompetencave transversale – digjitale, të gjelbra dhe sipërmarrëse – përmes kurrikulave të reja dhe mikrokredencialeve të akredituara.
9. Krijimi i një Komuniteti të Praktikës (Community of Practice) për shkëmbimin e përvojave, testimin e inovacioneve dhe sigurimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet rajoneve.

Takimi i parë ndërkufitar i projektit (TPM) – Nicosia, Cyprus

Takimi Hapës (Kick-Off Meeting) i projektit RAPPORT u zhvillua në Nikozia më 26 mars 2025. Ky takim i parë ndërkufitar shënoi nisjen zyrtare të bashkëpunimit ndërmjet partnerëve dhe vendosi themelet për zbatimin e suksesshëm të projektit.

Gjatë takimit u prezantuan dhe u diskutuan në detaje objektivat e përgjithshme, rezultatet e pritshme dhe ndikimi afatgjatë i RAPPORT. Çdo organizatë partnere prezantoi misionin, ekspertizën dhe rolin e saj brenda konsorciumit, duke nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë dhe forcimin e bashkëpunimit.

Vëmendje e veçantë iu kushtua qartësimin të strukturës së paketave të punës (Work Packages), deliverables, afateve kohore dhe përgjegjësi. Partnerët gjithashtu shqyrtuan aktivitetet e para të zbatimit dhe diskutuan procedurat e menaxhimit financiar dhe raportimit për të siguruar koordinim të qëndrueshëm gjatë gjithë ciklit të projektit.

Takimi krijoi një vizion të përbashkët të fortë dhe përforcoi angazhimin e të gjithë partnerëve për arritjen e objektivave të projektit.

Takimi i dytë ndërkufitar i projektit

Takimi i dytë ndërkufitar u zhvillua më 10 tetor 2025 dhe u fokusua në rishikimin e progresit dhe planifikimin e fazës së ardhshme të zbatimit. Duke u bazuar në përfundimin me sukses të aktiviteteve të Paketës së Punës 2, partnerët vlerësuan me kujdes rezultatet e workshopeve të ngritjes së kapaciteteve dhe diskutuan ndikimin e tyre në forcimin e kapaciteteve institucionale.

Një pikë kyçe e diskutimit ishte finalizimi i workshopeve dhe konsolidimi i mësimave të nxjerra. Konsorciumi gjithashtu u përgatit për nisjen e Paketës së Punës 3, e cila shënon kalimin nga faza e ngritjes së kapaciteteve drejt zhvillimit të kurrikulave dhe materialeve trajnuese. Takimi siguroi harmonizimin ndërmjet partnerëve dhe rikonfirmoi angazhimin e përbashkët për të ofruar rezultate cilësore, të bazuara në evidencë, që do të rrisin aftësinë e reagimit të sistemeve VET ndaj nevojave të tregut të punës.





PROJECT HIGHLIGHTS

Jemi të kënaqur të ndajmë progresin e rëndësishëm të arritur deri më tani në kuadër të projektit tonë. Work Package 2, i cili kishte dy objektiva kryesore, “ndërtimin e kapaciteteve të partnerëve dhe shumëfishimin e ndikimit të projektit”, ka përfunduar me sukses të gjitha aktivitetet e planifikuara.

Përveç aktiviteteve të zakonshme të menaxhimit të projektit, diseminimit dhe komunikimit, u organizuan me sukses shtatë workshope hibride. Këto workshope synuan forcimin e kapaciteteve të partnerëve të konsorciumit në fusha kyçe që lidhen me cilësinë dhe aftësinë e reagimit të Arsimit dhe Formimit Profesional (VET).

Fushat kryesore të trajtuara:

- Sigurimi i cilësisë
- Hartimi i kurrikulave
- Bashkëpunimi me aktorët e interesit dhe analiza e tregut të punës për aftësitë e së ardhmes
- Integrimi i soft skills në kurrikulat VET
- Validimi i të nxënit joformal
- Këshillimi për karrierën në VET
- Praktikat më të mira për përfshirje dhe aksesueshmëri

Feedback-u nga anëtarët e konsorciumit dhe pjesëmarrësit e jashtëm konfirmoi se workshopeve iu vlerësua një nivel shumë i lartë cilësie dhe suksesi.

Për të rritur më tej ndikimin e projektit, është zhvilluar një platformë online e të nxënit, e cila përmban të gjitha materialet microlearning të prodhuara gjatë workshopeve. Platformën mund ta eksploroni në linkun e mëposhtëm:

<https://elearn-rapport.projectsgallery.eu/>

LOOKING AHEAD

In addition to developing the Quality Assurance Manual and the Dissemination Strategy Guide, the RAPPORT Project has carried out several key research activities. These included:

- A large-scale questionnaire, which gathered 271 responses.
- Focus groups conducted in Albania, Bosnia and Herzegovina, Cyprus, Greece, and Italy, each involving at least eight stakeholders.

The purpose of these activities was to:

- Identify the skills necessary for employment in entry-level (junior) positions across different industries.
- Assess labor market needs related to digital, green, and entrepreneurial skills, recognized as transversal skills to be integrated into VET curricula.

Based on these findings, an Aggregate Report was produced. This report provides a solid evidence base for the next steps, including curriculum design, materials development, and the creation of microcredentials.

QËNDROJMË TË LIDHUR

Ju ftojme të vizitoni faqen tonë të projektit për të aksesuar këto materiale dhe për të mësuar më shumë rreth iniciativave tona. Angazhimi dhe feedback-u juaj janë shumë të vlefshëm për ne, ndërsa vazhdojmë të zhvillojmë dhe përmirësojmë aktivitetet dhe ofertat tona.

Gjithashtu, ju inkurajojmë të bëheni pjesë e komunitetit tonë aktiv në rrjetet sociale.


Na ndiqni në:

Facebook: <https://shorturl.at/V6deq>

LinkedIn: <https://shorturl.at/M90XA>

Website: [Rapport](#)





Koordinatori:

MMC Mediterranean
Management Centre

Contact Us:

Address: 16, Imvrou Street, 1055 Nicosia, Cyprus

Tel. No: +357 22466633

E-mail: europeanprojects@mmclearningsolutions.com

Website: www.mmclearningsolutions.com

Partnerët:



Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti financiar nuk mund të mbahen përgjegjës për to.